



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

**ODA E INFERMIERËVE MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË
SHËNDETËSOR TË KOSOVËS (OIK)**

DHE

ASOCIACION TË SPITALEVE PRIVATE TË KOSOVËS (ASPKS)

Neni 1

Përfaqësimi i palëve

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është hartuar me qëllim të organizimit të bashkëpunimit dhe forcimit të marrëdhënieve në mes të Institucioneve Private Shëndetësore dhe Odës së Infermierëve, Mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë të Kosovës.

Palët në rastin e nënshkrimit përfaqësohen nga:

- 1. Oda e Infermierëve Mamive dhe profesionistëve tjerë të Kosovës (nga tani e tutje OIK)** me adresë në rrugën Holger Pedersen, Lagjja e spitalit me nr. të regjistrimit 601731765 përfaqësohet nga Nexhmije Gori – Kryetare.

Dhe

- 2. Asociacioni i Spitaleve Private të Kosovës (nga tani e tutje ASPKS),** me adresë Rrafshi Kosovës nr. 150, me nr. të regjistrimit 5120142-6 dhe nr. fiskal 602957021, përfaqësohet nga Z. Armend Agani, Kryetar i Bordit.

Më tutje në tekst: PALËT.

Neni 2

Qëllimi

Ky memorandum ka për qëllim krijimin e një bashkëpunimi në mes të OIK dhe ASPKS për të zhvilluar një mekanizëm koordinues, në shkëmbim të informatave rreth të punësuarve anëtar të OIK-ut, dhe aktiviteteve profesional që synojnë zhvillimin e shërbimeve shëndetësore në Kosovë, përkrahjen e infermierëve mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë në rritjen e cilësisë së punës së tyre në institucionet private shëndetësore.

Qëllimi i këtij memorandumi është gjithashtu bashkëpunimi në përmirësimin e politikave dhe procedurave për ngritja e kapaciteteve profesionale të infermierëve mamive dhe profesionisteve tjerë shëndetësor, dhe përfaqësimi dinjitoz i interesave të tyre brenda institucioneve private shëndetësore.

Neni 3 Obligimet e palëve

OIK angazhohet të mbrojë dhe fuqizojë pozicionin e infermierëve mamive dhe profesionisteve tjerë shëndetësor brenda sektorit privat shëndetësor, duke promovuar standardet më të larta etike, mbështetje përmes edukimit të vazhdueshëm profesional dhe praktikës profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

ASPKS do të sigurojë mbështetje institucionale për implementimin e reformave dhe praktikave më të mira që lidhen me shërbimet e infermierëve mamive dhe profesionisteve tjerë shëndetësor në institucionet private shëndetësore.

ASPKS, në bashkëpunim me të gjitha institucionet brenda kuadrit të saj, zotohet se do të informojë saktësisht OIK-un për të dhënat e profesionistëve shëndetësorë të punësuar në institucionet private anëtare të saj dhe do të mbajë kontakte të vazhdueshme me të gjithë të punësuarit për përmbushjen e detyrimeve profesionale dhe obligimeve ligjore ndaj OIK-ut.

Palët zotohen të përmbushin të gjitha detyrat dhe aktivitetet e përcaktuara në planin e përbashkët të punës.

Neni 4 Komunikimi mes palëve

Palët angazhohen të mbajnë komunikim të rregullt dhe efektiv, dhe të shkëmbejnë informacionet e nevojshme duke mos cenuar interesat institucionale për zbatimin e këtij memorandumi. Komunikimi do të kryhet në mënyrë verbale dhe elektronike.

ASPKS angazhohet të mbajë komunikim të vazhdueshëm me OIK-un dhe të ofroj informacione për të punësuarit anëtar të OIK-ut në institucione që përfaqëson në çdo kohë kur kërkohet një informacion i tillë.

Të dy palët do të caktojnë nga një person përgjegjës për koordinim dhe komunikim të vazhdueshëm për çështjet që lidhen me implementimin e marrëveshjes.

Personat kontaktues nga të dyja palët do të jenë në dispozicion për komunikim, për të siguruar dakordimin e aktiviteteve dhe koordinimin e veprimeve të nevojshme për realizimin e bashkëpunimit.

Neni 5 Kohëzgjatja e Memorandumit të Bashkëpunimit

Ky memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të jetë i vlefshëm derisa palët të nënshkruajnë një dokument të ri që e shfuqizon ose modifikon atë.

Neni 6
Shkëputja e Memorandumit të Bashkëpunimit

Secila palë mund të tërhiqet nga ky memorandum duke njoftuar me shkrim palën tjetër së paku 30 ditë përpara.

Shkëputja mund të ndodhë nëse njëra palë nuk përmbush obligimet e saj, apo veprimet e ndërmarra ndikojnë negativisht në reputacionin e palës tjetër.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Ky memorandum nënshkruhet me datë 08. 10. 2024 në Prishtinë dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Neni 8
Dispozitat kalimtare

Ky memorandum do të rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Kosovës.

Çdo ndryshim në këtë memorandum do të kryhet me pëlqimin e të dyja palëve dhe kërkesa për modifikim duhet të dorëzohet së paku dy javë para.

Ky memorandum përgatitet dhe nënshkruhet në dy (2) kopje origjinale, dhe secila palë merr nga një kopje.

1. Oda e Infermierëve mamive dhe profesionisteve tjerë shëndetësor të Kosovës

Znj. Nexhmije Gori, Kryetare e OIK



2. Asociacioni i Spitaleve Private të Kosovës

Z.Armend Agani, Kryetar i Bordit

PËR ASPKS
ARTON KUBATI


Prishtinë 2024